



AIDA

Albanian Investment Development Agency
Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve

INDUSTRIA E PIJEVE DHE USHQIMIT



Adresa:
Rr. Skerdilajd Llagami
Nd.1, H.6,
Tiranë, Shqipëri

website: www.aida.gov.al
email: info@aida.gov.al
Tel: +355 042 251001



AIDA
Albanian Investment Development Agency
Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve

HISTORIKU I SEKTORIT DHE KARAKTERISTIKAT E TIJ

STATISTIKA TË VITEVE TË FUNDIT

KONTRIBUTI NË PUNËSIM

PESHA NË EKSPORT

RRITJA DHE QËNDRUESHMËRIA E SEKTORIT

TEKNOLOGJIA DHE INOVACIONI

STANDARDET DHE CERTIFIKIMI

AVANTAZHET E SEKTORIT

HISTORI SUKSESI

MBËSHTETJA E SEKTORIT NGA SHTETI DHE AIDA

HISTORIKU I SEKTORIT DHE KARAKTERISTIKAT E TIJ

Industria ushqimore është industria e prodhimit të produkteve ushqimore nëpërmjet përpunimit të lëndëve të para e ndihmëse kryesisht me prejardhje bujqësore e blegtorale.

Qëllimi kryesor i industrisë ushqimore është prodhimi i ushqimit për të përballuar nevojat dhe kërkesat e konsumatorëve. Industria ushqimore është e lidhur ngushtë me bujqësinë. Shqipëria njihet për traditën e prodhimit të verës dhe rakisë nga rushi e nga fruta të tjera, të vajit nga ullinjët, për përpunimin e frutave dhe perimeve, mishit, qumështit, peshkut etj. Përpunimi i produkteve ushqimore fillimisht, bëhej vetëm në ekonomitë shtëpiake si dhe nga zejtarë të veçantë, deri nga fundi i shek.XIX, kur filluan të ngrihen edhe punishte të veçanta si për miellin, sapunin, vajin etj.

Sot industria agropërpunuese përbëhet nga disa sektorë të rëndësishëm, si:

- Industria e përpunimit të qumështit (prodhim qumësht i pasterizuar, qumësht UHT, kos, gjalpë, lloje të ndryshme djathrash dhe produkte të tjera të fermentuara);
- Industria e përpunimit të mishit (prodhim sallamesh dhe proshutash);
- Industria e përpunimit të drithërave (prodhim mielli, prodhim buke, makarona dhe produkte të pjekjes);
- Industria e përpunimit të fruta-perimeve (prodhim lëngje frutash, produkte të konservuara si komposto, reçelna, koncentrate frutash, conserva dhe marinada perimesh, prodhim salce, ullinj etj);
- Industria e yndyrnave (prodhim vaji vegjetal, rafinim vaji vegjetal, prodhim vaj ulliri, prodhim majonezë);
- Industria e pijeve alkoolike dhe jo alkoolike (prodhim vere, birre, pije alkoolike, pije freskuese);
- Industria e prodhimit të vajrave medicinale nga bimët mjekësore;
- Industria e përpunimit të peshkut (përpunim peshku dhe prodhim konservash);
- Industri paketimi çajrash, sheqer, oriz, kafe, sheqer të pakeluar, pure patate, krem karamel, përgatitje për ëmbëlsira të ndryshme, etj.

Industria e pijeve është degë e industrisë ushqimore që në vendin tonë është e fokusuar në prodhimin e produkteve si verë, raki, alkool etilik, birra, pije alkoolike të tjera si dhe pije freskuese. Vera e më pas rakia janë prodhuar në Shqipëri që në lashtësi. Dikur, prodhimi i tyre bëhej kryesisht në punishte të vogla e më tepër në shtëpi. Në vitet 20-30 të shek. XX u ngritën disa fabrika të vogla alkooli etilik dhe një fabrikë birre në Korçë.

Pas viteve '90, filloi privatizimi i fabrikave dhe punishteve shtetërore, por njëkohësisht dhe një fazë e re modernizimi dhe zgjerimi jo vetëm i numrit të fabrikave dhe punishteve por edhe i gamës së produkteve ushqimore.

STATISTIKA TË VITEVE TË FUNDIT

Nga të dhëna të siguruara nga Agjencia Kombëtare e Ushqimit (AKU) dhe të konfirmuara nga vrojtimet e bëra nga Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar (KASH) në terren, numri i kompanive të agropërpunimit sipas aktivitetit të tyre paraqitet si në tabelën 1:

Tabela 1. Kompanitë e Agropërpunimit në Shqipëri

Aktiviteti	Viti 2019	Viti 2020
Përpunimi i mishit të shpendëve	22	26
Produkteve me bazë mishi	90	95
Konservimi i peshkut	15	14
Konservim fruta-perime	30	25
Prodhimi i vajit dhe yndyrnave të rafinuara	185	190
Qumësht dhe produkte qumështi	310	305
Prodhim akullore	43	45
Prodhim i miellit nga drithërat	108	130
Prodhim i bukës	1370	1387
Prodhim i biskotave dhe produkteve të pjekjes	12	12
Prodhim çokollate dhe ëmbël-sira	17	17
Prodhim makarona	48	35
Erëza dhe salca	9	15
Prodhimi i pijeve alkolike të distiluara	30	33
Prodhimi i verës nga rrushi	62	66
Prodhimi i birrës	10	9
Prodhimi i ujit mineral dhe pije freskuese	36	34
Të tjera	36	31
Total	2,433	2,469



KONTRIBUTI NË PUNËSIM

Industria e ushqimit dhe pijeve në vendin tonë, kryesisht përbëhet nga ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM). Ndarja vijon si më poshtë:

65% e industrisë përbëhet nga subjektet mikro (që kanë më pak se 9 punonjës)

24% përbëhet nga subjektet e vogla (që kanë 10-49 punonjës)

10% përbëhet nga subjektet e mesme (që kanë 50-249 punonjës)

1% përbëhet nga subjektet e mëdha (që kanë mbi 250 punonjës)

- Në 5 vitet e fundit, punësimi në këtë industri është rritur afërsisht me rreth 14.000 të punësuar;
- Të vetëpunësuarit zënë rreth 25% të numrit total të të punësuarve;
- Përkatësia gjinore e të punësuarve ndahet me 61% meshkuj dhe 39% femra;
- Punësimi në këtë industri përbëhet kryesisht nga grupmosha 20-55 vjeç;
- Paga mesatare është rreth 33,000 lekë;
- Vlen të theksohet që në këtë sektor, është mjaft i përhapur punësimi sezonal.



PESHA NË EKSPORT

Shqipëria renditet ndër vendet e para të Europës, për sa i përket kushteve natyrore dhe kapaciteteve për të prodhuar produkte bujqësore. Edhe pse vlera e shtuar në bujqësi zë rreth 20 % të Prodhimit të Brendshëm Bruto të vendit.

Shqipëria importon prodhime bujqësore më shumë sesa eksporton. Ky hendek thellohet më shumë kur kalojmë në analizën e eksporteve të pijeve dhe produkteve ushqimore. Një pengesë kryesore për eksportin e produkteve ushqimore, janë barrierat ligjore midis BE-së dhe vendeve jo anëtare.

Ndonëse vera shqiptare ka filluar të jetë konkurrese në tregun e brendshëm, mundësitë për eksport mbeten të largëta, ose të paktën nuk po shfrytëzohen sa duhet. Eksportet mbeten në vlera simbolike. Prodhuesit vendas të verës tregojnë se po tentojnë të gjejnë tregje të reja, por nuk e përjashtojnë faktin se e kanë të vështirë të konkurrojnë kantinat në rajon, e veçanërisht në Mal të Zi e Maqedoni. Tarifat doganore për importin janë të ulëta, ndërsa procedurat për eksport janë të shumta, duke përfshirë edhe koston e lartë të marketingut.

Por pavarësisht vështirësive, referuar të dhënave statistikore të INSTAT, vihet re rritje e eksporteve në vlerë dhe sasi, nga viti në vit. Kjo rritje, i dedikohet përpjekjeve të vazhdueshme të bizneseve për të përmirësuar standardet e tyre dhe për të rritur cilësinë dhe kapacitetet e prodhimit. Gjithashtu, rol kryesor kanë dhe institucionet shtetërore që i kanë dhënë prioritet përmirësimit të performancës së eksporteve nëpërmjet masave të ndërmarra si përafrimi i legjislacionit shqiptar me standardet ndërkombëtare dhe ngritja e programeve shtetërore të subvencionimit për këtë sektor.

Eksportet e grupmallrave “Pije dhe ushqime”, pavarësisht rritjes progresive në 5 vitet e fundit, janë akoma në vlerë rreth 4 herë më të vogël se importet.



Megjithatë, eksporti i produkteve ushqimore dhe pijeve shënoi rritje me rreth 4 miliardë lekë gjatë vitit 2020 duke arritur në 39 miliardë lekë nga 35 miliardë lekë që ishte në të njëjtën periudhë të vitit 2019. Ndikimin më të madh në këtë rritje e kanë dhënë eksportet e peshkut të përpunuar të cilat u rritën me 35% duke zënë mbi 20% të totalit të eksportit agrourbues.

Sipas të dhënave të publikuara nga INSTAT, grupi i mallrave “ushqime dhe pije” ishte ndër sektorët që jo vetëm i rezistoi pandemisë, por dhe arriti të shënojë rritje, pasi bujqësia vazhdoi punën edhe gjatë mbylljes së vendit në periudhën mars - maj 2020.

Ndikimin kryesor në këtë grup e kanë dhënë eksportet e produkteve bujqësore, ku përfshihen blegtorja,

bujqësia dhe agropërpunimi.

Produktet ushqimore të destinuara vetëm në vendet fqinje të rajonit të Ballkanit kryesisht në Kosovë, rezultuan 4 herë më të larta se e njëjta periudhë e vitit 2019.

Produktet ushqimore shqiptare kryesisht eksportohen drejt vendeve ballkanike, si dhe disa vende të Europës Qëndrore dhe Lindore. Shtetet kryesore drejt të cilave eksportohen këto grupmallra janë: Kosova, Maqedonia e Veriut, Mal i Zi, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kroaci, Serbi, Greqi, Dubai etj.

Produktet më të eksportuara ushqimore janë: produktet e përpunuara të peshkut, nënproduktet e qumështit, produktet e përpunuara të fruta-perimeve, uji mineral etj.

Tabelat 3 dhe 4 pasqyrojnë të dhënat për eksportet dhe importet për periudhën 2016 – 2020.

Tabela 3: Eksportet

Viti	2016	2017	2018	2019	2020
Exporte në vlerë (Lekë)	25,347,018,809	30,080,506,315	32,333,596,636	35,374,303,162	39,050,118,565

Tabela 4: Importet

Viti	2016	2017	2018	2019	2020
Importe në vlerë (Lekë)	100,364,877,160	106,737,760,484	106,507,701,057	110,365,172,605	110,926,658,856



RRITJA DHE QËNDRUESHMËRIA E SEKTORIT



Industria ushqimore ka qenë gjithmonë një zonë tërheqëse për investime, pasi kompanitë që prodhojnë ushqime dhe pije janë më rezistente ndaj fenomeneve të krizës sesa sektorët e tjerë industrialë. Industria e pijeve dhe ushqimeve konsiderohet nga ekspertët e ekonomisë si një industri me kërkesa konsumatore të qëndrueshme, që siguron të ardhura ekonomike të vazhdueshme dhe që në raport me industrinë e tjera është më rezistente ndaj periudhave të recensionit.

Konsolidimi i subjekteve ekzistuese në treg dhe rritja progresive e subjekteve që nisin aktivitetin në këtë sektor, dëshmojnë për një rritje të qëndrueshme të kësaj industrie.

Gjithashtu, referuar të dhënave të shoqatave kombëtare të prodhuesve, rreth 40% e subjekteve të kësaj industrie kanë rritur shfrytëzimin e kapaciteteve të tyre prodhuese, gjë që ndikon direkt në

efikasitetin dhe qëndrueshmërinë e kësaj industrie. Kështu, shumica e investimeve për vitin 2020 ishte 1,206,385,000 lekë (afërsisht 10 milionë Euro), me gjithë situatën e rëndë të krijuar në vendin tonë nga pandemia dhe tërmeti.

Rreth 65% e subjekteve që ushtrojnë aktivitetin në këtë industri, investojnë çdo vit në shtimin e makinerive të reja të prodhimit dhe mirëmbajtjen e sistemeve dhe makineri-pajisjeve ekzistuese.

Falë punës dhe koordinimit të subjekteve të industrisë ushqimore, me shoqatat e biznesit, organet shtetërore dhe donatorët, aktualisht 11 produkte tradicionale shqiptare, kanë arritur të pajisjen me markë cilësie. Këto produkte janë: Gështenja e Malësisë së Madhe, Mjalti i Gështenjës së Tropojës, Mjalti i Gështenjës së Malësisë së Madhe, Boronica e Bjeshkëve të Tropojës, Boronica e Bjeshkëve të Kukësit, Jufkat e Dibrës, Mjalti i Gështenjës së Reçit, Mishi i Dhisë së Hasit, Uji Korabi, Uji Glina dhe Vaj Borshi.

1) Certifikim i produkteve bujqësore - agroushqimore me 3 sisteme të përafuara me BE-në që janë: Emërtimi i Origjinës së Mbrojtur (EOM), Treguesi Gjeografik i Mbrojtur (TGJM) dhe Specialiteti Tradicional i Garantuar (STG)

TEKNOLOGJIA DHE INOVACIONI

Edhe në vendin tonë, me kalimin e kohës teknologjia dhe inovacioni kanë ardhur duke i forcur pozitën e tyre, me të njëjtat ritme si vendet e rajonit dhe Europës.

Pavarësisht, traditave dhe mënyrave artizanale dhe tradicionale për përpunimin e produkteve bujqësore dhe prodhimin e pijeve dhe ushqimeve, pas viteve '97-'98 biznesi shqiptar i kësaj industrie zgjodhi të investojë dhe të orientohet gjithnjë e më tepër drejt teknologjisë.

Sipas të dhënave nga "Shoqata e Prodhuesve Shqiptarë", rreth 86% e subjekteve të kësaj industrie, përdorin të paktën disa pajisje teknologjike në prodhimin e produkteve ushqimore dhe pijeve. Ndërsa, rreth 58% e këtyre subjekteve, kanë linjë të automatizuar prodhimi (të përmasave dhe specifikave të ndryshme).

Trendi i fundit i teknologjisë dhe inovacionit në këtë industri, aktualisht është:

- a) Shfrytëzimi i energjisë së rinovueshme (me qëllim zvoglimin e kostove të prodhimit).
- b) Orientimi i konsumatorit drejt ushqimeve funksionale. Sektori i prodhimit të këtyre ushqimeve ka pasur një rritje të madhe treg në vitet e fundit. Kjo rritje i dedikohet inovacionit në teknologjinë e prodhimit dhe zhvillimit të produkteve të reja.

STANDARDET DHE CERTIFIKIMI

Certifikimi i standardeve është një koncept që në vendin tonë ka filluar të përhapet masivisht pas viteve 2000. Disa nga standardet e certifikimit më të kërkuara dhe më të njohura në sektorin e industrisë ushqimore dhe pijeve në vendin tonë janë:

1. HACCP (Hazard Analysis of Critical Control Points) është një metodologji e njohur ndërkombëtare, një mjet, i cili për më shumë se 50 vjet, përdoret në një mënyrë sistematike për të parandaluar ose për të reduktuar aq sa është e mundur, rrezikun në prodhimin ushqimor. Kërkesat e HACCP mund të zbatohen në çdo pjesë të zinxhirit ushqimor, nga prodhimi dhe përpunimi primar deri në pikën e konsumit. Përdorimi i Standardit HACCP është bërë një detyrim për të gjithë operatorët në industrinë ushqimore që nga viti 2008.
2. ISO 22000:2005 (Sistemi i Manaxhimit të Sigurisë Ushqimore) është menduar për të gjitha kompanitë e përfshira në zinxhirin ushqimor (nga prodhuesit e ushqimit, prodhuesit e lëndës së parë deri tek konsumatorët e fundit, si dhe prodhuesit e materialeve që janë në kontakt me ushqimin), të cilat potencialisht mund të shkaktojnë ndotjen e ushqimit, pavarësisht nga madhësia e tyre dhe organizimi.



3. International Featured Standard ose standardi IFS Food, aplikohet kur produktet janë procesuar ose kur ka një rrezik për ndotje gjatë paketimit në ambalazhet primare. Standardi IFS Food është i rëndësishëm për të gjithë prodhuesit, në veçanti për prodhuesit nënkontraktorë, të cilët kanë për qëllim të përmbushin specifikat. Theksi i jepet sigurisë ushqimore dhe cilësisë së proceseve dhe produkteve.

4. Skema FSSC është një ndër gjashtë skemat e certifikimit, e njohur nga Shoqatat e tregtisë ndërkombëtare dhe furnizuesit e lëndës së parë. Kjo skemë certifikimi ka për objekt certifikimin e gjithë kompanive të përfshira në përpunimin ose prodhimin e:

- Produkte shtazore (përfshijto thertoret);
- Produkte afatshkurtër (që firojnë me kalimin e kohës);
- Produkte bimore me një afat të gjatë (vitamina, drithëra dhe aditivët e tjerë ushqimore).

5. Global GAP - Norma EUREPGAP është botuar për herë të parë në 1997. Publikuar nga Euro-shitësit dhe grupet prodhuese, grupi EUREP është i përbërë nga shitësit evropianë të ushqimit, fermerët dhe anëtarët e shoqatave të ndryshme të palëve të interesuara. Qëllimi i aplikimit është forcimi i besimit të konsumatorit në cilësinë dhe sigurinë e produkteve bujqësore; uljen e ndikimeve negative konvenciale të bujqësisë mbi mjedisin dhe shqetësimet e vazhdueshme në lidhje me shëndetin dhe sigurinë e të punësuarve në sektorin bujqësor dhe blegtoral. Pas dhjetë viteve të aplikimit të kërkesave EUREPGAP në Europë, zbatimi i tij u njoh edhe në kontinentet e tjera (Amerikë, Afrikë, Australi dhe Azi), dhe në shtator 2007, Grupi EUREP ndryshoi emrin nga normat EUREPGAP në normat Global GAP.

AVANTAZHET E SEKTORIT

Një nga avantazhet e mëdha të industrisë ushqimore është përfitimi i lartë dhe shpagimi i shpejtë i ndërmarrjes. Prandaj, shumë sipërmarrës vendosin të hapin një fabrikë për prodhimin e ushqimit.

Ndër avantazhet kryesore të kësaj industrie në vendin tonë janë:

1. Klima e mirë dhe e përshtatshme për kultivimin dhe prodhimin e larmishëm të produkteve bujqësore dhe blegtorale (të cilat përbëjnë dhe lëndën e parë bazë për industrinë ushqimore).
2. Infrastruktura e aksesueshme. Vendi ynë është një vend relativisht i vogël dhe me infrastrukturë lehtësisht të aksesueshme në pjesën më të madhe të tij. Këto karakteristika ndikojnë direkt në lehtësimin e kushteve të punës dhe minimizimin e kostove për industrinë e prodhimit të pijeve dhe produkteve ushqimore.
3. Çmime të mira dhe konkurrese të lëndës së parë të siguruar brenda vendit.
4. Marrëveshje tregtare preferenciale me BE-në për rritjen e eksporteve dhe marrëveshje tregtare preferenciale me vendet e Ballkanit (CEFTA).



HISTORI SUKSESI

KRACO është një kompani prodhuese, lider në Shqipëri në prodhimin e përgatitjeve për pije të ngrohta, pije të ftohta si edhe ëmbëlsira.

Kompania "Kraco" filloi aktivitetin në vitin 1997 si një nga kompanitë e para në industrinë e prodhimit të produkteve ushqimore. Produkti i parë i ofruar nga kompania ishte sheqeri i paketuar.

Kompania "Kraco" vit pas viti ka shtuar gamën e produkteve dhe aktualisht ofron: kapuçino, çokollatë të ngrohtë, çaj në filtër dhe të tretshëm me mbi 13 shije të ndryshme, salep, kakao, kafe ekspres në filtër, sheqer të paketuar, pure patate, krem karamel, përgatitje për ëmbëlsira të ndryshme, etj.

Kompania "Kraco" prodhon 77 artikuj të ndryshëm ushqimorë të cilat përdoren gjerësisht në të gjitha kanalet e shitjes: Horeca, Retail, B2B.

Kompania "Kraco" është ndër prodhuesit më të mëdhenj në rajon me një portofol kaq të larmishëm produktesh. Produktet e kompanisë "Kraco" mbulojnë tregun në të gjithë vendin tonë, si dhe eksportohen në të gjithë vendet ballkanike dhe në shumë vende të Europës qendrore dhe lindore.



MBËSHTETJA E SEKTORIT NGA SHTETI DHE AIDA

Sektori i prodhimeve vendase, si pije dhe ushqime, ka qenë në fokus të vazhdueshëm të prioritetëve të qeverisë shqiptare. Qeveria Shqiptare me buxhetin e saj por edhe në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë ka ofruar vazhdimisht mekanizma dhe skema financimi që nxisin zhvillimin dhe mbështetjen punën e subjekteve të industrisë pije dhe ushqim. Disa nga institucionet dhe partnerët e qeverisë që kanë luajtur rol kryesor në këtë proces janë: AZHBR, AIDA, IPARD, BERZH, GIZ etj.

Gjatë periudhës 2014-2019, AIDA nëpërmjet shërbimeve të saj ka mbështetur financiarisht rreth 54 subjekte që ushtrojnë aktivitetin në këtë sektor.

Mbështetja financiare është kryer nëpërmjet fondeve që AIDA ka manaxhuar dhe që kanë pasur përpuethshmëri me sektorin (Fondi i Konkurrueshmërisë; Fondi i Inovacionit; Fondi Start Up).

Gjithashtu, bizneset e këtij sektori, mund të gjejnë pranë AIDA-s cdo informacion të nevojshëm në lidhje me:

- Analiza sektoriale të tregut dhe sektorët e mundshëm për investime;
- Këshilla për gjetjen e pronave dhe vendndodhjeve të përshtatshme (në rastet kur kompanitë synojnë të zgjerohen ose të nisin një investim nga e para);
- Ndihma në identifikimin e projekteve të ardhshme dhe ekzistuese të investimeve në Shqipëri;
- Identifikimi i eksportuesve vendorë, partnerëve të biznesit ose kontakteve institucionale;
- Organizimi i eventeve B2B dhe panairove kombëtare dhe ndërkombëtare (me synim gjetjen e tregjeve të reja dhe/ose zgjerimin e tregut ekzistues);
- Grantet financiare dhe mundësitë e financimit nga projekte të ndryshme të BE-së, që kanë në fokus nxitjen dhe mbështetjen e prodhuesve shqiptarë në mënyrë që t'u mundësojnë atyre të konkurrojnë në tregje të reja.

Enterprise Europe Network



AIDA, nëpërmjet zbatimit të Rrjetit European të Ndërmarrjeve në Shqipëri (EEN-Albania), mundëson për biznesin shqiptar mbështetje, si:

- Marrëveshje ndërkombëtare (ekspertizë, kontakte, aktivitete për të lidhur kompanitë shqiptare me partnerë potencialë të huaj, për të rritur biznesin e tyre).
- Këshillim për rritje ndërkombëtare (këshillim nga ekspertët për rritje dhe zgjerim në tregjet ndërkombëtare).
- Inovacioni në biznes (shërbime të orientuara nga zgjidhja për të ndihmuar kompanitë të kthejnë idetë e tyre inovative në suksese tregtare ndërkombëtare).



ALBANIAN INVESTMENT DEVELOPMENT AGENCY

invest in Albania



Adresa:
Rr. Skerdilajd Llagami
Nd.1, H.6,
Tiranë, Shqipëri

website: www.aida.gov.al
email: info@aida.gov.al
Tel: +355 042 251001

